



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 336, datë 29.07.2021**

**PËR**

**CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT, PËR ZHVILLIMIN E PROCEDIMIT  
DISIPLINOR NR.5/2021, TË FILLUAR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
NDAJ MAGJISTRATES, ZNJ. {...}, ME DETYRË GJYQTARE NË GJYKATËN E  
RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “b” të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 138 dhe vijues të ligjit nr.96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 16 të Rregullores, “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, me propozim të Kryetarit të Komisionit Disiplinor, z.Medi Bici, pas hedhjes së shortit,

**VENDOSI:**

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, Z. Dritan Hallunaj, në cilësinë e relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.5/2021, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates, znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**